

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar pjesëmarrës,

Në frymën e përcaktimeve të Deklaratës së Limës<sup>1</sup> dhe të orientimeve të Raportit të SIGMA-s Nr. 33<sup>2</sup> “Marrëdhëniet mes Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Komisioneve Parlamentare”, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për pozicionin e Kryetarit të KLSH-së, në Platformën Strategjike<sup>3</sup> për zhvillimin e KLSH-së, paraqitur në Komisionin e Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, kam theksuar se një ndër objektivat kryesore të punës së institucionit në 7 vitet e ardhshme do të ishte: *“Intensifikimi i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2011- 2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues... Në zbatim të detyrimit kushtetues, KLSH do të shërbejë tërësisht si struktura numër një dhe më e besueshme e informimit të Kuvendit për mirëadministrimin e pronës shtetërore, si për shumicën ashtu dhe për pakicën parlamentare, nëpërmjet raporteve periodike të saj dhe takimeve e konsultimeve të herëpashershme me anëtarët e Kuvendit, por sidomos me Komisionin për Ekonominë dhe Financat”*. (nentor 2011)

xx

Në strategjinë e zhvillimit të KLSH 2013-2017, në Pikën 6 “Partnerët tanë strategjikë”, kemi theksuar se *“Kuvendi është partneri ynë kryesor... Kuvendi është i interesuar që KLSH të jetë një institucion i fuqishëm dhe profesional. Krahas shpërndarjes së burimeve publike në subjektet publike, ai ka deleguar edhe përgjegjësitë për përdorimin e tyre por ai mbetet i interesuar që të verifikojë se si janë përmbushur këto përgjegjësi. Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqitet si instrumenti kryesor për të verifikuar se si janë përmbushur përgjegjësitë e këtyre subjekteve në pikëpamje të funksioneve të deleguara me ligj. Partneriteti i KLSH me Kuvendin realizohet kryesisht nëpërmjet Komisionit të Ekonomisë dhe të Financave, i cili diskuton dhe i propozon Kuvendit çështje që kanë të bëjnë me Buxhetin e Shtetit dhe burimet publike në tërësi”*<sup>4</sup>.

xx

Sot, si auditues të jashtëm publik, jemi të bindur se ekziston një marrëdhënie simbiotike (e domosdoshme, jetike) mes Parlamentit dhe institucionit më të lartë të auditimit të jashtëm publik(SAI-t). Parlamenti dhe SAI kanë role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive. Ata përbëjnë dy elementë thelbësorë të një sistemi të balancuar të llogaridhënies së Qeverisë, të quajtur Trekëndëshi i Llogaridhënies, sipas studjuesit Rick Stapenhurst[stepënhër] dhe të tjerë<sup>5</sup>.

<sup>1</sup> Deklarata e Limës, Lima, Peru, 1977, [http://issai.org/media/12901/issai\\_1\\_e.pdf](http://issai.org/media/12901/issai_1_e.pdf)

<sup>2</sup> Raporti i SIGMA-s “Marrëdhëniet mes SAI-ve dhe Komisioneve Parlamentare”, Paris, 09 dhjetor 2002. <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/nispacee/unpan020450.pdf>


<sup>3</sup> Platforma Strategjike për Zhvillimin e KLSH-së, faqe 6.

[http://klsh.org.al/web/20120127090824projekide\\_70.pdf](http://klsh.org.al/web/20120127090824projekide_70.pdf)

<sup>4</sup> Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2013-2017, faqe 8.

[http://www.klsh.org.al/web/strategjia\\_klsh\\_2013\\_2017\\_937.pdf](http://www.klsh.org.al/web/strategjia_klsh_2013_2017_937.pdf)

<sup>5</sup> Rick Stapenhurst dhe të tjerë “Të ndjekësh paranë:Krahasimi i Komisioneve Parlamentare të Llogarive Publike”, Londër, 20 janar 2014, [www.amazon.co.uk/Following-Money-Parliamentary-Committees-Stapenhurst/dp/B01FKTMPXK](http://www.amazon.co.uk/Following-Money-Parliamentary-Committees-Stapenhurst/dp/B01FKTMPXK) , përshtatur për Shqipërinë



Parlamenti mund të kryejë funksionet e tij vitale të mbikëqyrjes së aktivitetit qeveritar në mënyrë eficiente dhe efektive, kur ai përdor dhe mund të mbështetet mbi punën audituese të SAI-t. Nga ana e tij, SAI mund të jetë shumë më efektiv, nëse Parlamenti dhe komisionet e tij sigurojnë forume për paraqitjen dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimeve të SAI-t, duke përbërë aleatin kyç në nxitjen e Ekzekutivit dhe në inkurajimin e institucioneve të tjera të pavarura, për të ndërmarrë veprimet e duhura korrigjuese të propozuara nga SAI.

### **Progresi i marrëdhënieve Parlament-SAI**

Marrëdhëniet mes Parlamenteve dhe SAI-ve janë forcuar dhe rritur gjatë dy-tre dekadave të fundit gati në të gjitha vendet e botës, përfshi dhe Shqipërinë, sidomos pas shpërthimit të krizës së përbotshme financiare dhe ekonomike të vitit 2008, kur roli i SAI-ve në shëndoshjen e financave publike u rrit ndjeshëm.

Në harkun kohor të tre viteve (22 dhjetor 2011-19 dhjetor 2014), në kuadrin e Axhendës së saj të Zhvillimit post 2015, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka miratuar dy Rezoluta për institucionet supreme të auditimit,

Rezolutën A/66/209 "*Nxitja e efciencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit*", dhe

Rezolutën A / 69/228: "*Promovimi dhe fuqizimi i efciences, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, me anë të forcimit të institucioneve të larta të auditimit*".

Me anë të tyre, OKB nxit parlamentet e Shteteve Anëtare të OKB-së të forcojnë pavarësinë e SAI-ve të vendeve të tyre dhe të bashkëpunojnë më fort me to. Miratimi i Rezolutave përbën kurorëzimin e përpjekjeve të bashkuara të SAI-ve nga i gjithë globi, në një lobim konkret dhe të mirëorganizuar nga ana e Organizatës së tyre INTOSAI, e cila numëron 192 SAI anëtare nga 192 shtete të botës.

Rezolutat kontribuojnë në njohjen dhe kuptimin e rëndësisë që kanë dokumentet themelore të auditimit publik suprem, Deklarata e Limës e vitit 1977 dhe Deklarata e Meksikos e vitit 2007. Këto dokumente, nëse njihen dhe zbatohen nga dhe parlamentet dhe SAI-t e Shteteve Anëtare të OKB-së, sigurojnë një auditim suprem të përgjegjshëm, profesional, të aftë të forcojë llogaridhënien dhe rrisë transparencën në administrimin e fondeve dhe aseteve publike.

Këto Rezoluta, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes në punën tonë, ne i kemi përkthyer në shqip dhe ia kemi kaluar në vitin 2015 Kuvendit dhe komisioneve të tij në formë fletëpalosje, si dhe kemi promovuar në opinionin publik dhe pranë palëve të tjera të interesit, përmbajtjen dhe rëndësinë e tyre.

Sipas Anders B. Johnsson, Sekretar i Përgjithshëm i Unionit Ndërparlamentar Botëror (IPU), *“Një studim i fundit i kryer nga IPU tregon se në shumicën e vendeve (85%) anetare të OKB-së, raporti i SAI-t përbën burimin kryesor të informacionit për Parlamentin në punën e tij kontrolluese”*<sup>6</sup>.

xxx

Më lejoni të cilësoj kontributin e rëndësishëm që ka dhënë Programi SIGMA i Bashkimit Evropian dhe i OECD-së (Mbështetja për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim) prej tashmë 26 vitesh në përmirësimin e qeverisjes publike në vendet candidate dhe potenciale candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Falenderoj SIGMA-n për ndihmesën e çmuar dhënë KLSH ndër vite, në veçanti Këshilltarët e Lartë të saj z. Joop Vrolijk, për kontributin në trajnimet e audituesve të institucionit dhe në hartimin dhe procesin e diskutimit të draft-ligjit organik të KLSH-së, si dhe z. Alastair [ellistër] Swarbrick [suorbrik] për ndihmesën e tij.

Vlerësoj SIGMA-n për Raportet e saj me Nr. 33 “Marredheniet mes Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Komisioneve Parlamentare” të datës 9 dhjetor 2002 dhe me Nr. 54 “Zhvillimi i Marrëdhënieve Efektive të Punës mes Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve”, të datës 12 maj 2017<sup>7</sup>, lidhur me situatën e marrëdhënieve Parlament-SAI, praktikat e mira të SAI-ve më të zhvilluara evropiane dhe sugjerimet konkrete për progresin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve, sidomos në optikën e SAI-ve të vendeve candidate dhe potenciale candidate për në BE.

Këto sugjerime na kanë ndihmuar ndjeshëm ne si SAI, si KLSH, në ndërtimin e një raporti efektiv dhe eficient me Kuvendin e Shqipërisë. Jam i sigurt se për përmbajtjen dhe rëndësinë e këtyre gjetjeve dhe orientimeve të SIGMA-s, do të flasë në detaje z. Alastair [ellistër] Swarbrick [suorbrik], Këshilltar i Lartë i SIGMA-s.

Dua të falenderoj SIGMA-n si për organizimin e këtij Takimi Ndërgjegjësimi, por edhe të një numri të konsiderueshëm takimesh, tryezash të rrumbullakta, seminaresh e konferencash, ndër të cilat veçoj Takimin dhe Marrëveshjen e Stambollit të datës 9 mars 2011, Konferencën dhe Rezolutën për Marrëdhëniet midis SAI-ve dhe Parlamenteve, mbajtur në Budva, Mal i Zi

<sup>6</sup> Anders B. Johnsson, fjala në Konferencën për Fuqizimin e Auditimit Publik të Jashtëm në rajonet e INTOSAI-t, maj 2010, Vjenë. <http://www.intosai.org/uploads/intosai/publikation02112010small.pdf>

<sup>7</sup> Raporti i SIGMA-s “Zhvillimi i Marrëdhënieve Efektive të Punës mes SAI-ve dhe Parlamenteve”, Paris, 12 maj 2017. [http://sigmaweb.org/publications/Supreme\\_audit-institutions-and-parliaments-SIGMA-Paper-No.%2054.pdf](http://sigmaweb.org/publications/Supreme_audit-institutions-and-parliaments-SIGMA-Paper-No.%2054.pdf)

më datat 18-20 nëntor 2013, si dhe Konferencën e mbajtur më datat 8-9 nëntor 2016 në Ankara, Turqi, mes SAI-ve të vendeve candidate dhe potenciale candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, me temë “Zhvillimi i marrëdhënieve efektive ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve”. Të tre keto evente kanë shërbyer si gurë kilometrikë në dhënien e mesazhit se puna audituese, gjetjet dhe rekomandimet e një SAI përbëjnë punë integrale të vetë Parlamentit, e parë kjo në këndvështrimin e qasjes “SAI si institucion watchdog i Parlamentit dhe qytetarëve”.

## **Marrëdhënia simbiotike Kuvend i Shqipërisë-KLSH**

Marrëdhëniet e Kontrollit të Lartë të Shtetit me Kuvendin e Shqipërisë, e sidomos me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, reflektojnë kërkesat e standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t për më shumë përgjegjësi në sistemin e llogaridhënies për përdorimin e fondeve publike, në veçanti të Deklaratës së Limës, e quajtur ndryshe “Magna Carta”, Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 1, Neni 8 “Marredhenia me Parlamentin”, i cili thekson se: *“Institucioni Suprem i Auditimit duhet të fuqizohet dhe të mandatohet nga Kushtetuta për t’i raportuar gjetjet e tij në mënyrë të pavarur dhe çdo vit Parlamentit”*, të ISSAI-t 12, “Vlerat dhe Përfitimet nga institucionet supreme të auditimit-të bësh diferencën në jetët e qytetarëve”, Parimi 6 “Komunikimi efektiv me Parlamentin dhe palët e tjera të interesuara”, i cili u kërkon SAI-ve të zhvillojnë marrëdhënie profesionale me Parlamentin dhe partnerët e tjerë, duke *“...komunikuar me Parlamentin dhe veprimtarët e tjerë të interesuar, në një mënyrë që të rrisin njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e rolit dhe përgjegjësisë të SAI-t, si një auditues i pavarur i sektorit publik”*<sup>8</sup>, si dhe të ISSAI-t 20, “Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies”, Parimi 7 *“SAI-t të mbajnë një marrëdhënie të fortë me komisionet përkatëse parlamentare për t’i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe të ndërmarrin veprimet e duhura”*.

Gjashtë vite e gjysëm më parë, vinim nga një traditë raportesh formale me Kuvendin, pothuajse tërësisht të përqëndruara në paraqitjen shabllone çdo vit të detyrimit kushtetues të raportimit mbi Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit për vitin pararendës dhe të raportimit mbi Performancën e KLSH. Nuk ishte e lehtë ta tejkalojë këtë mënyrë të menduarit.

Në filozofinë tonë të punës si institucion “whatchdog” i qytetarit dhe Kuvendit, zgjodhëm qasjen e promovimit të trekëndëshit të llogaridhënies “Parlamenti(qytetarët)” - KLSH - Qeveri”, në dobi të forcimit të llogaridhënies dhe transparencës së qeverisjes. Për këtë, synuam dhe kërkuam komunikim më të shpeshtë me Parlamentin, duke respektuar rregullin bazë që si institucion suprem i auditimit, si SAI, ne nuk bëjmë politika, por auditojmë zbatimin e tyre.

Pohojmë me mirënjohje që ky rregull përgjithësisht është mirëkuptuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Dëshmi konkrete e frymës pozitive të bashkëpunimit, me të cilin Kuvendi mirëpriti qasjen tonë, është nisma e rishikimit të ligjit integral të Kontrollit të Lartë të Shtetit, e përfunduar në nëndor 2014. Komisioni për Ekonominë dhe Financat, sidomos Kryetari z. Erjon Braçe dhe Sekretari i tij, Akademik Anastas Angjeli, por edhe deputetët Florjon Mima, Edmond Spaho, etj. të Komisionit dhe Kuvendit, luajtën një rol parësor për miratimin e një ligji modern për KLSH, tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t,

---

<sup>8</sup> ISSAI 12, <http://www.intosai.org/issai-executive-summaries/view/article/issai-12-the-value-and-benefits-of-supreme-audit-institutions-making-a-difference-to-the-liv.html>

çka ishte dhe një kërkesë e përsëritur e Bashkimit Evropian në Progres Raportet e tij për Shqipërinë për vitet 2011-2013.

Si KLSH, jemi perpjekur të konturojmë raportin me Kuvendin, në shinat e forcimit të llogaridhënies dhe transparencës. Në këtë konturim, na kanë ndihmuar gjetjet, përsiatjet me eksperiencat e SAI-ve të zhvilluara evropiane dhe konkluzionet e Raporteve të SIGMA-s Nr. 33 dhe Nr. 54, sidomos të këtij të fundit. Nëpërmjet tyre, kemi fituar qartësinë e mungesës së natyrshme që parlamentet kanë në kapacitete profesionale, për të kontrolluar përdorimin me ekonomicitet, efijencë dhe efektivitet të fondeve publike, si dhe të rolit tonë si SAI, po ashtu të natyrshëm, për të plotësuar këtë mungesë me informacion objektiv, me ekspertizë, dije dhe kapacitete, të cilat ne duhet t'i afrojmë, duke shpalosur vlerat e një SAI të pavarur, si integriteti, përgjegjshmëria, vlera e shtuar, profesionalizmi, etj.

Të ndihmuar nga Raportet e SIGMA-s dhe nga rezolutat e takimeve dhe konferencave të lartpërmendura, të organizuara nga ky Program, jemi perpjekur të përcjellim informacionin objektiv, ekspertizën dhe gjetjet nga auditimet, tek Kuvendi, nëpërmjet shtimit të komunikimit me komisionet e tij dhe paraqitjes në vëmendje të Kuvendit, jo vetëm të një numri të rëndësishëm të raporteve të auditimit, por edhe të informacioneve përmbledhëse për disa prej tyre.

Për shembull, gjatë vitit 2017, kemi paraqitur në Kuvend (Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Nën/Kryetarëve të Kuvendit, Komisionit për Ekonominë dhe Financat, komisioneve të tjera parlamentare) informacione mbi rekomandimet e auditimit në Bankën e Shqipërisë, informacion mbi auditimet në AlbPetrol, informacion mbi integritetin e zyrtarëve të administratës shtetërore, etj., krahas dërgimit të disa prej raporteve më të rëndësishme të auditimit.

Në tërësi, për vitin 2017, Kuvendi është njohur dhe informuar me hollësi për 38 auditime, ose mbi 24 përqind të auditimeve tona tërësore në vit. Kuptohet, Kuvendit i kanë kaluar raportet më të rëndësishme në tematika dhe impaktin e shpresuar nga auditimi. Përqindja rritet, kur flasim për raporte të auditimit të institucioneve qendrore ose raporte të auditimit të performancës. Për këtë vit, synojmë të informojmë dhe sensibilizojmë Kuvendin dhe komisionet e tij, për rreth 30 përqind të auditimeve tona tërësore.

Vullneti për thellimin e bashkëpunimit ka qenë reciprok. Pjesëmarrja e Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe deputetëve në aktivitetet e KLSH-së, si analizat Vjetore, konferencat shkencore, por edhe në aktivitete ndërkombëtare, dëshmon për mbështetjen parlamentare.

## **Rezoluta e Kuvendit**

Në vitin 2016, Kuvendi miratoi Rezolutën e datës 20 tetor 2016, “Mbi performancën e Kontrollit të Lartë i Shtetit të vitit 2015“, ku theksohet që *“Kuvendi i Shqipërisë, në funksion të detyrimeve të tij kushtetuese, por dhe në zbatim të rekomandimeve të Progres Raportit 2015 të Komisionit Evropian për ngritjen e një mekanizmi më efijent nga Kuvendi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, shpreh angazhimin e tij maksimal në këtë drejtim, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe ushtrimin e kontrollit parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, sa më poshtë:*

*- Të bashkëpunojë me KLSH-në dhe Qeverinë, që të rritet shkalla e ndërveprimit gjithëpërfshirës me të gjitha institucionet e administratës publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;*

- *Të shikojë mundësinë e krijimit të Nënkomisionit Parlamentar brenda Komisionit për Ekonominë dhe Financat për të monitoruar në mënyrë sistematike aktivitetin e KLSH-së dhe zbatimin e rekomandimeve*".

Menjëherë kemi dhënë dakordësinë tonë për krijimin e nënkomisionit të dedikuar parlamentar. Për të gjitha detyrat e lëna nga rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë, ato të viteve 2012, 2014 dhe 2016, si SAI kemi hartuar plane konkrete pune për zbatimin e tyre.

Jemi të ndërgjegjshëm që rrugët e komunikimit dhe përcjelljes së ekspertizës nga auditimet, në kanalet dhe mënyrat se si ky informacion mund të shfrytëzohet nga Parlamenti dhe komisionet e tij, janë të shumëllojshme. Në këtë drejtim, na ngelet shumë për të bërë.

### **Sfida e së ardhmes**

Sikurse shprehet edhe Raporti i SIGMA-s Nr. 54 në pikën 1.2.2 "Komunikimi-të kuptuarit të rolit dhe punës së SAI-ve", "...përcjellja formale e raporteve të auditimit nuk mjafton për të stimuluar ndjekjen e duhur të zbatimit të rekomandimeve dhe veprimin nga ana e Parlamentit. SAI-t kanë nevojë të bëjnë më shumë për të shpjeguar rolin e tyre dhe punën që bëjnë"<sup>9</sup>.

Na pret përpara një sfidë e madhe. Me Vendimin e Kryetarit Nr. 56, datë 30 prill 2018, KLSH miratoi Kodin e Etikës së Kryetarit, i cili njih dhe pranon pa asnjë kushtëzim Kodin e Etikës së Deputetit të Kuvendit. Ky standard hap rrugën, në kushtet e mungesës totale të konfliktit të interesit për 6 muajt e ardhshëm në përfundim të mandatit të kryetarit aktual, për një marrëveshje të gjerë kuadër KLSH-Kuvend, të cilën me këtë rast ia propozoj Kryetarit të Kuvendit.

Si KLSH, si SAI, në bazë të standardeve të INTOSAI-t, të Rezolutave të OKB-së dhe të Raporteve të SIGMA-s, gjykojmë se marrëveshja duhet të përfshijë jo vetëm fuqizimin e ndjekjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, si plotësim edhe të rekomandimit të njëjtë(forcimi i ndjekjes parlamentare) të dhënë nga Progres Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë në tre vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018, por edhe një axhendë konkrete për zbatimin e rekomandimit qendror të KLSH-së në këto vite, për draftimin dhe miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik, si dhe angazhimin juridik të Qeverisë për nxjerrjen e Urdhërit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga ana e institucioneve në varësi të saj.

Ka ardhur koha e krijimit të Nënkomisionit të dedikuar të Kuvendit, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për shqyrtimin e gjetjeve dhe rekomandimeve nga raportet e auditimit të KLSH, nën shembujt e praktikave të mira të sugjeruara nga Raporti Nr. 54 i SIGMA-s (faqe 43 "Përvojat evropiane për trajtimin e raporteve të SAI-t").

Në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022, Pika 4 "Partnerët strategjikë", theksohet se "Cilësia dhe besueshmëria e raporteve të auditimeve të KLSH po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e parlamentarëve, duke rritur mundësinë e funksionimit të mekanizmave të "Trekëndëshit të Llogaridhënies" (SAI-Parlament-Qeveri), pasi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit orientohen pikërisht drejt identifikimit dhe zgjidhjes së problematikave të qeverisjes publike, duke kontribuar për mirëqeverisjen"<sup>10</sup>.

<sup>9</sup> Raporti i SIGMA-s "Zhvillimi i Marrëdhënieve Efektive të Punës mes SAI-ve dhe Parlamenteve", Paris, 12 maj 2017, faqe 13, fragmenti i parë. [http://sigmaweb.org/publications/Supreme\\_audit-institutions-and-parliaments-SIGMA-Paper-No.%2054.pdf](http://sigmaweb.org/publications/Supreme_audit-institutions-and-parliaments-SIGMA-Paper-No.%2054.pdf)

<sup>10</sup> Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022, faqe 39, paragrafi i parë. Kolana "Botimet KLSH", 2018

Investimi kryesor i së ardhmes për një SAI është forcimi i besimit të qytetarëve dhe Parlamentit në rolin dhe vlerën e shtuar të punës së tij. Si auditues të KLSH, si trupë auditimi që synon të shndërrohet në një formacion auditues modern evropian, garantojmë se do të kushtojmë të gjitha kapacitetet dhe energjitë tona në realizimin e këtij investimi madhor.

Ju faleminderit!